LIGJ
Nr. 12/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9942, DATË 26.6.2008, "PËR PARANDALIMIN E ÇRREGULLIMEVE TË SHKAKTUARA NGA PAMJAFTUESHMËRIA E JODIT NË ORGANIZMIN E NJERIUT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9942, datë 26.6.2008, "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në të gjithë përmbajtjen e ligjit emërtimi "Ministri/a i/e Shëndetësisë" zëvendësohet me "ministri/a përgjegjës/e për shëndetësinë" dhe emërtimi "Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit" zëvendësohet me emërtimin "struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit".

Neni 2

Në nenin 3, termat "konsum direkt" dhe "konsum indirekt" zëvendësohen përkatësisht me termat "konsum i drejtpërdrejtë" dhe "konsum i tërthortë".

Neni 3

Në nenin 9, pas paragrafit të parë, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

"duke përjashtuar rastet si më poshtë:

a) importimin e kripës ushqimore të pajodizuar vetëm me qëllimin e fortifikimit të kripës me jod nga subjekte të licencuara për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin, duke garantuar gjurmueshmërinë;

b) importimin e kripës ushqimore të pajodizuar, me qëllim përdorimin e saj në produktet ushqimore të destinuara për eksport, duke garantuar gjurmueshmërinë;

c) eksportimin e kripës së pajodizuar dhe të ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar, duke garantuar gjurmueshmërinë.".

Neni 4

Neni 12 riformulohet si më poshtë:

"Neni 12
Kontrolli i nivelit të jodit në kripë

1. Kripa e jodizuar, e prodhuar në vend ose e importuar, e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë, është objekt kontrolli, që përfshin veprimtaritë e mëposhtme:

a) monitorimin, i cili kryhet nga drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë;

b) inspektimin, i cili kryhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit.

2. Kontrolli i nivelit të jodit në kripë, në subjektet prodhuese të kripës ushqimore të jodizuar, bëhet për çdo parti malli përpara hedhjes së saj në treg nga struktura rajonale e shëndetësisë. Për kryerjen e analizave të kripës, struktura rajonale përdor laboratorët e brendshëm të saj.

3. Kontrolli i nivelit të jodit në kripën ushqimore të prodhuar në vend ose të importuar, e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë, bëhet nëpërmjet analizave laboratorike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas rekomandimeve të OBSH-së, ICCIDD-it dhe UNICEF-it.

4. Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike të nevojshme për kontrollin e kripës së jodizuar përballohen nga subjektet prodhuese ose importuese të kripës së jodizuar. Tarifat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Kripa e jodizuar, që importohet në Republikën e Shqipërisë nga subjektet importuese, i nënshtrohet kontrollit për nivelin e jodit në pikat doganore (degët doganore kufitare). Ky kontroll realizohet nga autoriteti doganor, drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë brenda juridiksionit të tyre dhe inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë.

6. Për kripën e jodizuar të importit, edhe në rastet kur në dokumentet shoqëruese është pasqyruar niveli i jodit, importuesi është i detyruar të kryejë analizën laboratorike në laboratorët e strukturës rajonale të shëndetësisë për nivelin e jodit në çastin e futjes së kripës në pikën doganore.".

Neni 5

Neni 13 riformulohet si më poshtë:

"Neni 13
Monitorimi i nivelit të jodit në kripë

1. Monitorimi është procesi sistematik i mbledhjes së mostrave të kripës së jodizuar, analizimit dhe përdorimit të informacionit me qëllim sigurimin e niveleve të jodit në kripën e destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Monitorimi i nivelit të jodit në kripë në pikat e prodhimit në vend apo në ato të importimit dhe në pikat e shitjes me pakicë/shumicë kryhet nga drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë brenda juridiksionit të tyre, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e këtij institucioni.

3. Prodhuesi i kripës së jodizuar në vend dhe importuesi i saj janë përgjegjës për sigurimin e nivelit të jodit në kripë, në përputhje me standardet e këtij ligji.".

Neni 6

Pas nenit 13/1 shtohet neni 13/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 13/2

Kërkesat për gjurmueshmërinë e kripës për konsum njerëzor, shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore

1. Operatori i biznesit ushqimor krijon dhe mban informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, jodizimit të kripës dhe shpërndarjes së saj.

2. Informacioni i nevojshëm për gjurmueshmërinë përfshin këto të dhëna:

a) identifikimin e çdo subjekti tregtar/personi juridik apo fizik nga i cili operatori i biznesit ushqimor është furnizuar me kripë;

b) identifikimin e çdo subjekti tregtar, të cilin operatori i biznesit ushqimor e ka furnizuar me kripë të jodizuar;

c) sasinë e kripës së furnizuar dhe nivelin e jodit në momentin e furnizimit;

ç) datën e skadencës së kripës së furnizuar.

3. Operatori i biznesit ushqimor ruan të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni për jo më pak se 3 vjet dhe siguron që këto të dhëna t'u jepen menjëherë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe inspektoratit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Kripa ushqimore e nxjerrë në treg ose që mund të nxirret në treg, duhet të etiketohet e të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër për të siguruar gjurmueshmërinë.".

Neni 7

Në nenin 17, në fund të pikave 1 dhe 2, shtohen fjalët si më poshtë:

"me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj".

Neni 8

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 4, pika 4, të këtij ligji.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.2.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11445, datë 4.3.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.